

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 1 e Ligjit për vetëqeverisje lokale (Gazeta Zyrtare e R.M-së nr 05/02), nenit 46 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Sarajit (Fletore Zyrtare e Komunës së Sarajit nr.14/06), dhe në pajtim me Vendimin Statutarë për ndryshim dhe plotësim të Statutit nr. 0901-104/1 të datës 11.03.2016 (Fletore Zyrtare e Komunës së Sarajit nr.3/16), Këshilli i Komunës së Sarajit në mbledhjen e 4-të mbajtur më 22.04.2016 sjell;

STATUT TË KOMUNËS SË SARAJIT

(tekst i konsoliduar)

1. DISPOZITAT THEMELORE

neni 1

Komuna e Sarajit (në tekstin e mëposhtëm Komuna) është njësi e Vetqeverisjes Lokale, në të cilën qytetarët e realizojnë të drejtën e Vetqeverisjes Lokale. Komuna është njësi e Vetqeverisjes Lokale, si bashkësi e banorëve të një teritori të përcaktuar me Ligj, nëpërmjet së cilës përmes organeve dhe administrates si dhe shërbimeve publike, mundëson kryerjen e kompetencave të përshkruara me Ligj. E drejta e Vetqeverisjes Lokale realizohet përmes përfaqësuesve në organet e Komunës dhe organet e Qytetit të Shkupit si njësi e posaçme e Vetqeverisjes Lokale dhe pjesmarrjes direkte në vendosje me procedurës të përcaktuar Ligjore.

Teritori i Komunës

neni 2

Teritori i Komunës së Sarajit është i përcaktuar me Ligj dhe i përfshin teritorët e vendbanimit Saraj dhe fshatrat: Arnaqi, Bojanë, Bukoviq, Gllumovë, Svillare e Sipërme , Gërçec, Dvorcë, Svillare e Poshtme, Kondovë, Kopanicë, Krushopek, Llaskarcë, Lubin, Matkë, Paniçar, Radush, Raoviq, Rashçe, Rudnik Radusha Semenishtë, Çajlanë dhe Shishovë.

Banor të Sarajit

neni 3

Qytetarët e Republikës së Maqedonisë të cilët kanë vendbanim të përhershëm në teritorin e Komunës së Sarajit, janë banor të Komunës së Sarajit.

neni 4

Komuna është subjekt juridik Selia e Komunës

neni 5

Selia e Kumunës gjendet në Saraj

neni 6

Komuna ka të drejtën e pronës Stema dhe flamuri i Komunës

neni 7

Komuna ka stemën dhe flamurin të cilat rregullohen me vendim të Këshillit të Komunës. Stema dhe flamuri i Komunës përdoren njëkohësisht me stemën dhe flamurin e Qytetit të Shkupit

Përdorimi i Flamujve

neni 8

Në Komunën e Sarajit në përdorim zyrtar janë: Flamuri shtetëror dhe flamuri kombëtar shqiptar.